



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikë së Maqedonisë, numër 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar për denoncim për korrupsion të parashtruesit nga, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK) në vazhdimin e seancës së 42-të të mbajtur me me datë 14.12.2020, morri

VENDIM

Procedura për lëndën 12-2425 nga viti 2019, formuar pas denoncimit numër 12-2425/1 me datë 17.04.2019 dorëzuar nga parashtruesi nga **NDËRPRITET**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për lëndën 12-2425 nga viti 2019.

Lënda me numër 12-2425 nga viti 2019, të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK me sqarimin.

Vendim i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin, në formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e vendimmarrjes.

Sqarim

Lënda me numër 12-2425 nga viti 2019 e formuar pas denoncimit nr.12-2425/1 me datë 17.04.2019, dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nga parashtruesi nga

Në denoncim janë treguar akuza kundër Shoqatës së pensionistëve në Komunën e, për paligjësi në punën e tyre, keqmenaxhim dhe harxhim të mjeteve të Shoqatës si dhe keqpërdorim të mjeteve finansiare në fonde për solidaritet dhe taksën e antarësisë për antarësim.

Gjatë rishikimit të rastit të lëndës, KSHPK i merr parasyshtë akuzat e parashtruesit dhe në drejtim të caktimit të gjendjes faktike, dorëzoi kërkesë deri tek Inspektorati shtetëror administrativ dhe deri tek Ministria për punë dhe politikë sociale për mbledhje të të dhënave dhe informacione në lidhje me rastin e lëndës. Pas kërkesës së KSHPK janë dorëzuar lajmërimet e kërkuara dhe pas analizimit të dokumentacionit të plotë me të cilën disponon për rastin e fjalës, nga ana e KSHPK është caktuar gjendja faktike vijuese:

- Në rastin konkret bëhet fjalë për akuza për punë joligjore dhe kriminele e Shoqatës së pensionistëve në Komunën në të cilën vetë parashtruesi ka qenë kryetar i nëndegës Shkup dhe sekretarë, për mosrespektim të statusit të shoqatës, pagesa e honorareve të larta dhe marrja e vendimeve kriminele, menaxhim joligjor i mjeteve nga fondi për solidaritet, shpenzime të mëdha për prezentime gjatë shëtitjeve të pensionistëve të cilët vetë i kan paguar harxhimet e rrugës, larje e parave me urdhër dhe për nevojat e Lidhjes së pensionistëve të Maqedonisë në bazë të qirasë nga shtëpia e pensionistëve në Katllanovë dhe shitore në Bit Pzar, etj

Parashtruesi i denoncimit gjatë tregimit të punës joligjore nga ana e udhëheqësisë së tashme ka marrë shumë kërcënime, dhe në lidhje me rastin dorëzoi denoncim deri në Inspektoratin shtetëror administrativ nga i cili nuk është i kënaqur se si veproi, dhe gjithashtu u drejtua dhe deri në Ministrinë për punë dhe politikë sociale personalisht deri tek ministresha mirëpo nuk ka marrë përgjigje.

- Me datë 27.05.2020, me kërkesë të KSHPK është marrë përgjigje nga Ministria për punë dhe politikë sociale – Sektori për sigurim pensional dhe invalidor, me të cilën lajmërohet se është bërë inspektim në librin protokolar të arkivës së Ministrisë për punë dhe politikë sociale me çka është konstatuar se në lidhje me të kërkesën e sipërshënuar nga grup pensionerë, është vepruar me shkresë deri në Ministrinë për punë dhe politikë sociale nr./..... me datë 02.10.2017. njëkohësisht lajmërojnë se duke vepruar sipas Ligjit për material arkivues dhe Rregullores për punë në zyrë, si dhe në përputhje me planin dhe listën e arkivës nga viti 2017, dhe duke pas parasyshë karakterin e lëndës (shënim me shifër 0905 dhe afat të ruajtjes për njëvit), lënda me të gjitha shënimet nga ana e Sektorit për sigurim pensional dhe invalidor është dorëzuar deri në Arkivën shtetërore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për asgjësim, dhe në përputhje me të theksuarën Ministria nuk ka qenë në gjendje plotësisht të vepron në lidhje me kërkesën e KSHPK, gjegjësisht të dorëzon kopje nga dokumentacioni kompetent për lëndën
- Me datë 17.06.2020 është dorëzuar informacion deri në Inspektoratin shtetëror administrativ me të cilën lajmërohen se nga ana e personi nga është dorëzuar denoncim/ankesë deri në Inspektoratin shtetëror administrativ me datë 29.06.2016 pas të cilës në vitin 2017 është formuar lëndë e cila ka qenë shpërndarë në punën e inspektorit të Inspektoratit shtetëror administrativ i cili në vitin 2018 i plotësoi kushtet për pensionim dhe ka kaluar në pension të moshës. Për veprimin kompetent është përgaditur procesverbal dhe Vendim me datë 24.10.2017 për bërjen e inspektimit të jashtëzakonshëm në Shoqatën e pensionistëve në komunën e Shkup, me qëllim të caktimit të gjendjes në përputhje me Ligjin për inspektim administrativ. Gjatë inspektimit është konstatuar parregullsi dhe atë se libri protokolues si libër për evidencë kryesore nuk është udhëhequr në përputhje me Rregulloren për punë në zyra dhe arkivë dhe se Shoqata nuk disponon me "shenja të vulës së pranuar" si dhe se nuk është mbajtur evidencë e rregullt të evidencës së dokumenteve/procesverbaleve.

Për menjanim të mangësive në pjesë e punës në zyra, inspektori morri vendim me datë 24.10.2017 me caktimin e afatit për realizimin e saj dhe nëpërmjet postës aktet e inspektimit rregullisht janë dorëzuar në subjektin ku është bërë kontrollimi nga inspektori që është parë nga dorëzimi i kthyer nga posta e cila ekziston në lëndën dhe gjithashtu me lajmërimin me datë 24.10.2017 dhe 18.12.2017 është lajmëruar dhe parashtruesi, për kontrollimin e bërë si dhe për atë se inspektorati administrativ nuk ka qenë kompetent për kontroll të punës financiare të Shoqatës, dhe e udhëzon për atë të drejtohet deri në Kuvendin, Këshillin ekzekutiv dhe Bordin mbikqyrësin i Shoqatës, dhe gjithashtu ka lajmëruar se inspektorati administrativ nuk ka qenë kompetent që ta asgjëson vendimin për shkarkim të asaj që është marrë nga ana e Këshillit ekzekutiv me datë 19.09.2015, si dhe ta kthen në punë në Shoqatë.

Në fund, Inspektorati shtetëror administrativ lajmëron se në institucionet/objektet në të cilat është bërë inspektim, ai nuk ka marrë kompetenca të kontrollojë dhe caktojë keqpërdorim të mjeteve financiar të institucionit.

Në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, KSHPK konstatoi se në rastin e lëndës është vepruar nga ana e organeve tjera kompetente në vitin 2017 dhe atë nga Inspektorati shtetëror administrativ dhe Ministria për punë dhe politikë sociale – Sektori për sigurim pensional dhe invalidor, të cilët kanë vepruar në përputhje me kompetencat e veta ligjore dhe për përfundimet nga veprimet e tyre rregullisht është informuar parashtruesi dhe gjatë asaj është treguar se në lidhje me dyshimet për keqpërdorim të mjeteve financiare të shoqatës së përmendur ta informon organin kompetent, gjegjësisht Bordin mbikqyrë të Shoqatës i cili ka bërë kontroll dhe mbikqyrje të shpenzimeve të qëllimshme të mjeteve me të cilat disponon Shoqata. Duke pasë parasyshë konstatimin, KSHPK vlerëson se nuk ka elemente për veprimtë më tutjeshëm për rastin e lëndës, procedura për lëndën ndërpritet, kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke pasë parasyshë të theksuarën mësipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Është vendosur me datë 14 Dhjetor 2020, me numër 12-1918/5

Dorëzuar deri te: arkiva dhe parashtruesi
Pas përfundimit të KSHPK
Punoi: J.C., këshilltarë
Miratoi: m-r Sh. S., anëtar i KSHPK

KOMISIONI SHTETËRORE PËR
PARANDALIM TË KORRUPTIONIT
Kryetar: Biljana Ivanovska